



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1000/Prot.

Tiranë, më 26. 4. 2021

VENDIM

Nr. 10, datë 26 . 04 . 2021

“Për miratimin e riorganizimit të programit të studimeve të doktoratës në “Shkencat e Natyrës”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së, për vitin akademik 2021-2022”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2/b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1/dh; neni 77 dhe neni 91, pika 3; VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MASR, nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, gërma “E”; Udhëzimin e MASR, nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat “f” dhe “j”, si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me shkresat nr. 414/13-14-15-16-17 prot., datë 19.04.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 26.04.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë riorganizimin e programit të studimeve të doktoratës në “Shkencat e Natyrës” (në fushën e shkencave natyrore sipas manualit të FRASCAT-it), në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, sipas nënfushave të mëposhtme:
 - “Shkenca Biologjike”
 - “Fizikë”
 - “Matematikë”
 - “Informatikë”
 - “Matematikë e Aplikuar”
 - “Analiza Kimike e Avancuar dhe Aplikimet e saj”
 - “Elektrokimi e Zbatuar dhe Dukuritë Sipërfaqësore”
 - “Bioteknologji”
 - “Prodhim Industrial dhe Inxhinieri”
2. Të miratojë formën e diplomës, për programin e studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së.

3. Dokumentacioni përkatës t'i përcillet për miratim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Pas miratimit të MASR-së, sipas pikës 3 të këtij vendimi, dokumentacioni përkatës të përcillet edhe në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha

